



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KUVENDI I KOMUNËS

01 Nr. 06/01-622/2018

Datë. 23.01.2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dytë e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2018, e mbajtur me datën 23.01.2018, me fillim në orën 10.00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi : Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Anton Shala .

Në mbledhje marrin pjesë 34 anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Haxhi Sejdiu, z. Nik Hyseni, z. Jusuf Osmani, z. Shaban Luma, znj. Teuta Pallaska –Milla , znj. Florentina Gjergjaj, znj. Albina Sadrija, z. Muharrem Musa, z. Faton Gutaj, znj. Dijana Qarkagjija, z. Basri Komoni, znj. Hana Zeka , znj. Edi Puka, znj. Drita Buza - Zhaveli, z. Jeton Vorfi, z. Agon Batusha, z. Shpend Komnova , znj. Mimoza Shala , znj. Lirika Komoni , z. Krishnik Alijaj, z. Bekim Jupa , z. Halit Isufi , znj. Dafina Syla , z. Bashkim Gashaj, z. Bekim Ermeni, z. Sadik Hoti, znj. Saranda Hoda, znj. Besarta Lekaj, z. Anton Shala, z. Zef Komani, znj. Arjeta Gjoklaj, z. Fazli Hoxha, znj. Valentina Alijaj, z. Edmond Dushi .

Mungojnë : znj. Miranada Lushaj, z. Bekim Ermeni, me arsye.

Të pranishëm të tjerë: Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, Nënkryetari i Komunës z. Ramadan Hoti, Drejtoret e Drejtorive Komunale, përfaqësues të ZKKK-së, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal, si dhe përfaqësues nga mediat e shkruara dhe elektronike dhe qytetarë të Komunës së Gjakovës.

Kryesuesi: I nderuar Kryetar i Komunës z. Ardian Gjini, të nderuar anëtarë të pranishëm të Kuvendit të Komunës, Drejtor të drejtorive Komunale Të nderuar përfaqësues të Mediave, të OSBE, të nderuar të pranishëm.

Sot do ta kemi mbledhjen e dytë të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, ju njoftoj se Kuvendi për këtë mbledhje i ka 35 anëtarë, z. Faton Gutaj nga subjekti politik AAK është certifikuar nga KQZ dhe tani është anëtar i Kuvendit të komunës së Gjakovës, të pranishëm në këtë mbledhje janë: 33, anëtarë, z. Bekim Ermeni na ka njoftuar se do të mungojë për arsye të udhëtimit jashtë vendit, meqenëse ekziston kuorumi po fillojmë me mbledhjen .

Para se të kalojmë tek pikat e rendit të ditës e ftoi që të bëj betimin anëtari i ri i Kuvendit të Komunës z. Faton Gutaj nga Subjekti Politik AAK ,

z. Faton Gutaj: Unë Faton Gutaj “Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, me besnikëri, e pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Gjakovës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Konstatohet se z. Faton Gutaj , e bëri betimin sipas Ligjit për vetëqeverisje Lokale .

Kryesuesi: Urime z. Gutaj ju dëshirojmë suksese në angazhimet e juaja .

Kryesuesi : Rendin e ditës për këtë mbledhje e keni marrë së bashku me ftesën dhe materialin e mbledhjes, mirëpo MAPL-ja e ka kthyer për rishqyrtim Vendimin për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa për shkak të mos përmbushjes së kotës për barazi gjinore në këtë komitet edhe përkundër kërkesës sonë të vazhdueshme që të kemi përfaqësim të mjaftueshëm të gjinisë femërore në këtë komitet andaj kërkoj që kjo pikë të jetë si pikë e rendit të ditës për këtë mbledhjeje , gjithashtu kemi edhe një kërkesë për plotësimin e përbërjes së Komitetit për Komunitete sepse kemi një gabim tek përkatësja etnike e njërit nga këta anëtar kështu që duhet të përmirësohet ky gabim si dhe të zëvendësohet me një anëtarë tjetër nga komuniteti tjetër . Andaj a ka dikush ndonjë propozim sa i përket Rendit të Ditës, që të shtohen edhe këto dy pika të rendit të ditës .

Znj. Drita Buza Zhaveli: Ne si Grup i Alternativës kërkojmë që të futet si pikë e rendit të ditës kërkesa për rishqyrtimin e vendimit për themelimin e komiteti për politik dhe financa sepse është i miratuar në kundërshtim me rregulloren për punën e Kuvendit, duke e ditur rendësin e këtij komiteti dhe rregulloren për punën e Kuvendit janë përcaktuar anëtarët e KPF-së pa marra parasysh numrin e ulëseve në Kuvend, si dhe pa e arritur kuotën ligjore, andaj kërkojmë që të hyj si pikë e rendit të ditës kjo kërkesë dhe të harmonizohet sipas kësaj rregulloreje .

Kryesuesi: Ne patëm mirëkuptim që të ju dëgjojmë deri në fund edhe pse ne paraprakisht propozuam që kjo pikë të hyjë në rend ditë për këtë mbledhë, si dhe plotësimi i vendimit të Komiteti për Komunitete .

E qes në Votim Rendin e Ditës për mbledhjen e sotme sipas që të shtohen edhe Rishqyrtimi i Vendimit për themelimin e KPF-së dhe Plotësimi i Vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete . Kush është: Për, Kundër, Abstenim

Nga anëtarët e Kuvendit unanimisht u miratua Ky :

REND DITE

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Kuvendit e mbajtur me dt. 05.01.2018 .
2. Rishqyrtimi i Vendimit për Themelimin e Komitetit për Politik dhe Financa
3. Plotësim Ndryshimi i Vendimit për Themelimin e Komitetit për Komunitete
4. Kërkesë për përmirësimin e vendimit 01 nr. 011/01-16322/2017 i datës 04.07.2017
5. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale “Ngrohtorja e Qytetit” .
6. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale KRM “Çabrat” .
7. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale “Stacioni i Autobusëve “ .
8. Të ndryshme.

1. Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Kuvendit e mbajtur me dt. 05.01.2018 .

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimin e procesverbalit nga mbledhja me dt. 05.01.2018, a ka dikush ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket këtij procesverballi .

E qes në Votimi miratimin e Procesverbalit , **Kush është: Për, kundër, Abstenim**

Nga Anëtarët e Kuvendit të Komunës Unanimisht u miratua procesverballi nga mbledhja e Kuvendit e mbajtur me dt.05.01.2018 .

2. Pika e dytë e rendit të ditës: Rishqyrtimi i Vendimit për Themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa .

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi kërkesën për rishqyrtimin e vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, kërkesë kjo e MAPL-s për shkak të mos përmbushjes së kriterit të përqindjes së Barazisë gjinore , edhe për kundër kërkesës tonë të vazhdueshme për të gjitha subjektet politike që të keni anëtarë të gjinisë femërore për këtë komitete që është shumë i rëndësishëm, e që për fat të keq nuk kemi hasur në mirëkuptim që të përmbushet kjo kërkesë ligjore për çka unë edhe tani po kërkoj nga Subjektet politike këtu në Kuvend që të bëjmë zëvendësimin e një anëtari të këtij komiteti me Gjinin Femërore, nëse nuk ka gatishmëri ne duhet që të fillojmë nga subjektet më të vogla në këtë rast nga z. Dushi për të cilin kemi qenë të gjithë të pajtuar që të jetë pjesë e KPF-së mirëpo tani kërkojmë që të ndryshohet ky vendim për shkak të përfaqësimit gjinor .

E hapi diskutimin :

z. Edmond Dushi: Fillimisht ju uroj të gjithëve për marrjen mandatit dhe ju dëshiroj suksese. Kërkoj nga Kryesuesi që për të gjitha pikat të hapë diskutim e jo vetëm me një propozim ta hedh në votim sepse mund të dalin propozime të ndryshme .

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës ne pajtohem me kuotën e barazisë gjinore edhe pse në shkresën e MAPL-së është cituar Ligji për barazi gjinore e që kërkohet 50% mirëpo në ligjet për vetëqeverisje Lokale kërkohet 30%. Unë kërkoj sqarime se a do të ruhet kjo përbërje 5 pozita dhe 4 opozita, opozitë apo do të ndryshohet ky bilanc nëse unë nuk do të jem pjesë e KPF-së, nëse qëndrojmë më këtë raport atëherë duhet të kërkohet një zgjidhje duhet të kërkohet një zgjidhje nga ana e pozitës e nëse ky raport do të ndryshohet atëherë duhet të diskutojmë dhe të shohim se si do të veprojmë .

z. Jeton Vorfi: Me qenë se Ligji për Vetëqeverisje lokale na mundëson që të kemi 9 deri në 11 anëtar të KPF-së ne si parti e dyta për nga numri i ulëseve në Kuvend kishte me qenë më e drejtë që të kemi edhe një anëtar më shumë dhe të përmbushet edhe përqindja e femrave që është e kërkuar .

Kryetari: Arsyeja pse kemi mbërritur deri në këtë pikë ka qenë që të përfshihen të gjitha subjektet politike në KPF dhe tani po ta lëvizim këtë përbërje duhet një formë tjetër e organizimit të këtij komiteti andaj propozoj që për këtë pikë të diskutojmë në piken e fundit dhe të vazhdojmë me pikat tjera të radhës dhe të marrim një pauzë që të gjejmë një zgjidhje të përbashkët .

Kryesuesi: A Pajtoheni me propozimin e kryetarit që të vazhdojmë me pikat tjera të radhës dhe për këtë pikë të diskutojmë në pikën e fundit pas një konsultimi që do të kemi bashkërisht , Kush është për këtë propozim, kundër , abstenim.

Nga anëtarët e Kuvendit unanimisht u përkrah ky propozim .

3.Pika e tretë e rendit të ditës: Plotësim Ndryshimi i Komitetit për Komunitete

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit e kemi plotësim Ndryshimin e Komitetit për Komunitete, ku në vendimin e mbledhjes së kaluar kemi pasur një gabim tek përkatësia etnike e këtyre anëtareve ku z. Fadil Podrimja nuk është i komunitetit egjiptian por i komunitetit Ashkali andaj kemi propozimin që z. Fadil Podrimja të jetë në vende të z. Zenel Hajdari përfaqësues i Komunitetit Ashkali dhe në vend të z. Fadil Podrimja përfaqësues i Komunitetit egjiptian të jetë z. Bislim Hoti .
E Hapi diskutimin për këtë pikë

Kryesuesi: E qes në votim këtë ndryshim të përbërjes së Komitetit për Komunitete sipas përbërjes së propozuar : **Kush është: Për, Kundër, Abstenim .**
Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu: 32 pro, 1 kundër dhe 0 abstenim, pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Gjakovës e ka këtë përbërje:

1. znj. Elvana Qorri, përfaqësuese e Komunitetit Egjiptian
2. z. Bislim Hoti, përfaqësues i Komunitetit Egjiptian
3. z. Senad Gushani, përfaqësues i Komunitetit Rom
4. z. Fadil Podrimja, përfaqësues i Komunitetit Ashkali
5. znj. Ifeta Jakupi , përfaqësuese e Komunitetit Boshnjak
6. z. Jusuf Osmani, përfaqësues i AAK-së
7. znj.Edi Gaxha Puka , përfaqësuese e Alternativës
8. znj. Dafina Syla , përfaqësuese e PDK-së
9. znj. Mimoza Shala , përfaqësuese e VV-së

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës.

4.Pika e katërt e rendit të ditës: Kërkesë për përmirësimin e vendimit 01 nr. 011/01-16322/2017 i datës 04.07.2017

Kryesuesi: Për këtë pikë e kemi Kërkesë për përmirësimin e vendimit 01 nr. 011/01-16322/2017 i datës 04.07.2017, me të cilin është shpallur interesi publik në pronën e ish ndërmarrjes metaliku për sigurimin e qasjes fizike në lokacionin ku do të ndërtohet objekti i Impiantit të ujërave të zeza, mirëpo gjatë hartimit të dokumentacionit është bërë një gabim teknik tek numri i pronës i cili është shënuar gabimisht 79-0 ZK Zidi i Sadik Ages , e që duhet të jetë 97-0, pra është një gabim teknik dhe Vendimet e Kuvendit për ç'do ndërhyrje duhet të kalojnë në Kuvend sepse është protokolluar dhe i ka shkuar Ministrisë, andaj kërkohet vetëm ky përmirësim dhe nuk ka as një ndryshim tjetër, pjesa e tjetër e vendimit mbetet në Fuqi. Bashkangjitur ne materialet e juaja i gjeni vendimin qe duhet të përmirësohet , kërkesën nga DUMM-ja dhe Hartën e lokacionit .

E Hapi diskutimin për këtë pikë

Kryesuesi: E qes në votim Kërkesën për përmirësimin e vendimit 01 nr. 011/01-16322/2017 i datës 04.07.2017: **Kush është: Për, Kundër, Abstenim .**
Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës në mënyrë u votua Kështu : **Unanimisht u votua pro.** pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

Për përmirësimin e vendimit 01 nr. 011/01-16322/2017 i datës 04.07.2017.

1. Përmirësohet pika 1 e vendimit 01 nr. 011/01-16322/2017 i datës 04.07.2017 i Kuvendit të Komunës së Gjakovës, ashtu që numri i parcelës Kadastrale ndërtimore 70705070-79-0 përmirësohet në 70705070-97-0 Z. K. Zidi i Sadik Agë, e evidentuar si rrugë Publike në Pronësi të ish ndërmarrjes Metaliku.
2. Pjesa tjetër e vendimit 01 nr. 011/01-16322/2017 i datës 04.07.2017 mbetet në Fuqi .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës .

5. Pika e pestë e rendit të ditës: Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale “Ngrohtorja e Qytetit” .

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit e kemi Formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale “Ngrohtorja e Qytetit” bashkangjitur në materialet e mbledhjeve e keni vendimin e kryetarit të komunës që e ka emërtuar njërin nga anëtarët e këtij komisioni procedurë kjo që rregullohet me Ligjin për ndërmarrjet Publike ku një Anëtar emërtohet nga kryetari i Komunës dhe dy të tjerë nga Kuvendi i Komunës, nga Kryetari i Komunës është emërtuar z.Dukagjin Vezesja, ndërsa partitë e pozitës i kanë dhënë dy kandidat që janë z. Zef Komani dhe z. Bashkim Gashaj .

E hapi diskutimin për këtë pikë .

z. Jeton Vorfi: Në kuadër të Alternativës ne kemi një eksperte të kësaj lamiye është znj. Hana Zeka me profesion Ekologe e specializuar pikërisht në Biomase që edhe ngrohtorja do të punoj me këtë sistem, andaj e propozojmë znj. Hana Zeka .

Kryesuesi: E qes në votim formimin e komisionit Komunal të aksionareve për Ndërmarrjen Publike Komunale “Ngrohtorja e Qytetit, me këtë përbërje z. Dukagjin Vesvesja i emërtuar nga kryetari i Komunës , z. Zef Komani nga PSHDK, dhe z. Bashkim Gashaj nga PDK: **Kush është për Kundër Abstenim** . Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u votua kështu: 18 pro, 8 kundër dhe 3 abstenim . pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale, “Ngrohtorja e Qytetit “ në Gjakovë, në këtë përbërje:

1. z. Dukagjin Vesvesja , i emëruar nga Kryetari i Komunës.
2. z. Zef Komoni, përfaqësues i Kuvendit .
3. z. Bashkim Gashaj, përfaqësues i Kuvendit .

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës : Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale KRM “Çabrati” .

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit e kemi Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale **KRM “Çabrati”**, procedura të njëjta sikurse në pikën paraprake janë edhe për këtë pikë nga Kryetari i Komunës është emërtuar z. Afrim Dervishi andaj , ndërsa nga partitë në koalicion është propozuar z. Bekim Jupa , andaj kërkojmë nga partitë opozitare që të paraqesin një propozim, fillimisht subjektin Alternativa

Kryesuesi: E hap diskutimin për këtë pikë

Z. Jeton Vorfi: Ne jemi dakorduar që të propozojmë profesionistë të lëmive dhe kemi propozuar për Ngrohoren e Qytetit znj. Hana Zeka, andaj për këtë komision do të kenë kandidatin Vetëvendosja .

z. Agon Batusha: U cek edhe nga z. Jeton Vorfi ne kemi bërë një marrëveshje mirëpo nga pozita u hedh poshtë ajo marrëveshje e jona me formimin e komisionit paraprak , andaj ne si Vetëvendosje e propozojmë z. Kreshnik Alijaj .

Kryesuesi: E qes në votim, Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale KRM ” Çabrati “ me këtë përbërje, z. Afrim Dervishi i emërtuar nga Kryetari i Komunës , z. Bekim Jupa nga PDK-ja dhe z. Kreshnik Alijaj nga Vetëvendosje , kush është: Për, kundër, Abstenim. Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u Votua kështu : 26 pro, 0 Kundër dhe 4 abstenime . Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale, KRM “Çabrati” në Gjakovë, në këtë përbërje:

1. z. Afrim Dervishi, i emëruar nga Kryetari i Komunës.
2. z. Bekim Jupa, përfaqësues i Kuvendit.
3. z. Kreshnik Alijaj, përfaqësues i Kuvendit.

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës .

7. Pika e shtatë e rendit të Ditës : Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale “Stacioni i Autobusëve “

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit e kemi Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale **Stacioni i Autobusëve**, procedura të njëjta sikurse në pikat paraprake janë edhe për këtë pikë nga Kryetari i Komunës është emërtuar znj. Kujtesa Qela, ndërsa nga AAK është propozuar z. Faton Gutaj, dhe kërkojmë nga Alternativa që ta kemi edhe një Propozim .

E hap Diskutimin për këtë pikë .

z. Basri Komoni : Nga subjekti Politik Alternativa e propozojmë dr. Jeton Vorfi.

Kryesuesi: E qes në votim, Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale “Stacioni i Autobusëve “ me këtë përbërje, znj. Kujtesa Qela , e emërtuar nga Kryetari i Komunës, z. Faton Gutaj nga AAK dhe z. Jeton Vorfi nga Alternativa kush është: Për, kundër, Abstenim . Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës u Votua kështu : 30 pro, 2 Kundër dhe 0 abstenime . Pas votimit Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale “Stacioni i Autobusëve” në Gjakovë, në këtë përbërje:

1. znj. Kujtesa Qela, e emëruar nga Kryetari i Komunës.
2. z. Faton Gutaj , përfaqësues i Kuvendit .
3. z. Jeton Vorfi, Përfaqësues i Kuvendit .

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës

Kryesuesi: Ashtu siç u dakorduar me propozimin e Kryetarit kërkojmë që të kemi një Pauzë dhe të takohemi me shefat e grupeve në zyrën time për konsultime lidhur me pikën e rendit të ditës rishqyrtimi i Vendimit për themelimin e KPF-së .

Pas Pauzës Kuvendi vazhdon Punimet , në ora 11:20

Kryesuesi: Po vazhdojmë me mbledhjen të pranishëm janë 33 anëtar , andaj fillimisht fjalën e ka Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini

Kryetari : Unë fillimisht i falënderoj partnerët e koalicionit që u dakorduan dhe gjetëm një zgjidhje, që në vend të z Edmond Dushit nga AKR-ja të jetë znj. Hana Zeka nga Alternativa që do të përmbushet kushti i kërkuar për përfaqësim në KPF të barazisë Gjimore .

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

z. Agon Batusha: E përshëndesë këtë zgjidhje që të kemi një përfaqësim të të gjitha forcave politike të përfaqësuar në KPF, dhe ruajtja e këtij balanci që për mua ka shumë rëndësi dhe e mbështesim propozimin për Hana Zekën .

z. Zef Komani: E falënderoj pozitën për këtë kompromis dhe kërkoj nga opozita që edhe në të ardhmen të mbizotëroj kjo frymë e bashkëpunimit për të mirën e qytetarëve të Komunës së Gjakovës .

Kryesuesi: E Ftoj Alternativen që të bëjë propozimin e tyre .

z. Jeton Vorfi : Alternativa e propozon znj. Hana Zeka për anëtare të KPF-së .

Kryesuesi: E qes në votim përbërjen e plotë të KPF-së , kush është pro, kundër , abstenim.

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës në mënyrë u votua Kështu : **Unanimisht u votua pro.** pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Gjakovës prej 9 (Nëntë) anëtarëve , me këtë përbërje:

1. z. Haxhi Sejdiu përfaqësues nga AAK .
2. znj. Florentina Gjergjaj, përfaqësuese nga AAK.
3. znj. Diana Qarkagjija , përfaqësuese nga Alternativa
4. znj. Hana Zeka, përfaqësuese nga Alternativa .
5. z. Bekim Jupa , përfaqësues nga PDK.
6. z. Agon Batusha, përfaqësues nga VV.
7. z. Bekim Ermeni, përfaqësues nga LDK
8. z . Anton Shala, Kryesues i Kuvendit .
9. z. Fazli Hoxha, përfaqësues nga NISMA.

2. Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. **Anton Shala**.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës

8 Pika e tetë e rendit të Ditës: Të Ndryshme

Kryesuesi: E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës .

z. Edmond Dushi: Kërkoj nga kryetari që për mbledhjen e radhës bashkë me materialet e mbledhjes ti na dërgohet edhe Buxheti i vitit 2018 dhe lista e projekteve kapitale të miratuara në këtë buxhet, si dhe kërkesa tjetër për kryesuesin, që të dërgohet Statuti i Komunës dhe rregullorja e Punës së Kuvendit .

Kryesuesi: Këto dokumente janë në web faqe dhe janë publike mirëpo keni të drejtë ti kërkonit dhe do të ju dërgojmë .

z. Edmond Dushi: Faqja Zyrtare e Komunës nuk është duke punuar dhe pajtona që mos të bëjmë shpenzime të pa nevojshme të letrës por të na dërgohet në kopje elektronike .

z. Agon Batusha: Në emër të LVV e shprehim shqetësimin për organizimin e ekskursioneve në sezonin e dimrit sepse të gjithë jemi në diji për vështirësitë që kanë hasur nxënësit në këtë organizim , kemi njohuri se edhe kryetari është shkuar atje dhe është kujdesur për këta fëmijë që e ka pasur edhe vajzën e vetë . Shqetësimi jonë është se këto organizime janë duke u bërë nga Individ e jo nga DKA-ja as nga drejtorët e shkollave dhe jo nga këshilli i nxënësve, andaj kjo ka ndodhur për shkak të organizimit të individëve për interesa të tyre dhe zyrtarët e shkollave dhe të DKA-së nuk kanë marrë as një masë, sepse me sa kemi informata autobusët nuk kanë pasur as pajisjet e nevojshme dimërore andaj kërkojmë që të merren masat dhe kjo dukuri mos të ndodhë në të ardhmen .

Kryesuesi: Kjo është një dukuri që po e përcjell komunën vit pas viti e që duhet të merren masa , sa i përket asaj që u tha atje ka qenë edhe Kryetari i Komunës që ka shkuar të kujdeset për këta nxënës për çka edhe e falënderojmë, fjalën e ka kryetari i Komunës .

Kryetari : Ne duhet të ndalojmë bartjen e organizuar të nxënësve pa pëlqimin e DKA-së dhe pa prezencën e arsimtarëve dhe kompanitë që i bartin nxënësit duhet ti plotësojnë kriteret e kërkuara dhe ne kemi vetëm

një muaj që e kemi marrë detyrën dhe do të merremi me këtë problem, Sa i përket asaj nate unë kamë qenë deri në 2:30 të mëngjesit atje deri sa janë siguruar të gjithë nxënësit , kamë qenë në Polici në Shterpcë në Ambulant , kam pritje deri sa kanë shkuar FSK-ja në Prevallë, ne kemi biseduar me drejtorin e Arsimit dhe do të nxjerrim rregullore për këtë temë sepse atë natë fëmijët tonë kanë qenë në rrezik , prandaj unë bashkërisht edhe me ju do të merremi me këtë çështje .

z. Agon Batusha : Kjo ka ndodhur në vazhdimësi, që është përdorur emri i shkollës edhe pse nuk ka qenë shkolla bartësi i këtyre organizimi andaj ne duhet të merren masa për parandalimin e këtyre dukurive dhe mos të keqpërdoret emri i shkollave për përfitime personale, falënderoj kryetarin për gatishmërinë dhe për modestin e treguar në këtë rast .

z. Muharrem Musa : Unë e kamë një kërkesë nga Qytetarët e Dushkajës lidhur me rrugën e Dushkajës që kërkojmë që kjo rrugë ti kaloj në kompetencë të Ministrisë sepse siç e dini është një rrugë e gjatë dhe është e vështirë që të mirëmbahet dhe tani është në një gjendje jo të mirë dhe komuna e ka të vështirë që të mirëmbahet pra kërkojmë që të kaloj në Kompetencë të Ministrisë .

Kemi edhe një kërkesë nga Fshati Bec ku në qendër të fshatit është një korporatave e cila është nën menaxhim të AKP-së andaj banorët e këtij lokaliteti kërkojnë që të gjendet një zgjidhje që ajo pronë të kaloj në pronë komunale dhe mos ti ipet mundësia që ajo pronë mos të privatizohet sepse është në oborrin e shkollës dhe kjo i shërben edhe shkollës duke e ditur se nuk ka hapsin të mjaftueshëm .

Kryetari: Kërkesa për rrugën e Dushkajës mendoj se është e logjishme dhe është në të mirë të komunës dhe shpenzimet janë më të vogla për Komunën andaj ne duhet të vejmë kontaktet me Ministrinë dhe ta pyesim se a dëshiron me e marrë në menaxhim sepse ka mundësi më të madhe për investim , pra është një propozim i mirë . Ndërsa sa i përket ndërmarrjeve privatizimi në gjakove është me specifik në Gjakovë, unë kamë dëshirë që ti kthejmë të gjitha në pronësi të Komunës andaj do të angazhohemi dhe ti drejtohem me shkresë Ministrisë dhe AKP-së .

Znj. Dafina Syla: Unë dua të informohemi se çfarë po ndodhë me banimet sociale deri ku ka shkuar aplikimi për banim çfarë po ndodhë me ata përfitues, sepse kemi familje që kanë shumë nevojë për strehim dhe jetojnë në gjendje të mjerueshme andaj kërkoj sqarime nga kryetari i Komunës se si do të vepron për këtë çështje .

Kryetari: E ceka edhe më lartë se ne kemi vetëm një muaj që e kemi marrë mandatin dhe ende nuk e kemi marrë as një vendim për shfuqizimin e vendimeve të më parëshme për këtë çështje sepse është tepër shqetësuese me marrë një vendim me i largu ndonjë familje nga këto banese e cila nuk ka banim tjetër, sepse ka familje që ka marrë vendim për me u larguar nga këto banesa e nuk ka ku të shkoj andaj ne nuk dëshirojmë të krijojmë situata të tilla . Ne do të kemi politik për strehim Social e jo të nxjerrim vendime ad, hoc pra të kemi një politik afatgjatë dhe të kemi një strategji për strehim social .Do të jemi tepër të kujdesshëm që mos të nxjerrim dikur nga banesa sociale kur nuk ka ku të shkoi, andaj kjo është arsyeja që unë do të ndërtoj Politik të banimit social dhe do të kemi një plan më afatgjatë për banim Social .

z. Zef Komani: E falënderoj kolegën që e ngriti këtë temë dhe pajtohem që të kemi një listë të të gjithë shfrytëzuesve të banimit social sepse kemi shfrytëzues që nuk i plotëson kriteret për këtë banim dhe kemi familje që nuk kanë kulm mbi kokë dhe nuk kanë strehim .

Dua që ti njoftoi anëtarët e Kuvendit se kemi filluar një iniciativë në nivel të Kosovës në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave për ngritjen e pagave të Anëtarëve të Kuvendeve komunale sepse pagat janë lëmosh , e duke e pasur parasysh me punën tone dhe me problemet që ballafaqohemi, andaj kërkoj nga ju pajtim se a do ta nënshkruani një kërkesë për këtë çështje a jo, sepse me këtë pagesë në një të ardhë të afërt nuk do të ketë as nivel të asamblistëve .

Kryesuesi: Iniciativa të tilla janë të mirëseardhura dhe mënoj se kjo iniciativë le të vazhdoj mirëpo nuk e kemi temë për këtë takim.

z. Jeton Vorfi: Unë kamë qenë anëtar i komisionit për banim social dhe dua të ju siguroi se të gjitha vendimet e marra në atë komisioni kanë qenë në kuadër të ligjit dhe nuk ka asgjë në kundërshtim me ligjin, dhe mundeni lirisht ti verifikoni , Mendoj se duhet që mbledhjes së Kuvendit ti paraprijë mbajtja e mbledhjes së KPF-së

z. Fazli Hoxha: Sa i përket iniciativës për rritjen e pagave për asamblist unë jam kundër sepse na lejohet një punë e dytë dhe 80% e tyre punojnë , ndërsa për çështjen e banimit social të formohet një komision dhe të bëhet verifikimi sepse ka shfrytëzues që e kanë shtëpinë në fshat dhe është i vendosur në këto banesa sepse ne e dimë se në çfarë rrethana janë bërë përzgjedhjet, ndërsa ka familje që më të vërtetë kanë nevojë për strehim dhe nuk janë përzgjedhur .

z. Jusuf Osmani: Ne jemi dëshmitarë se në vitin e kaluar KF “ Dardanët “ ka mbetur pa teren Sportiv i cili ka ekzistuar me dekada, për shkak të privatizimit të egër që ka ndodhë , ne ju kemi drejtuar qeverisjes së kaluar dhe nuk kemi marrë as një përgjigjeje konkrete , , tani Klubi ju ka drejtuar edhe një herë me një kërkesë Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës , andaj pyetja ime është , se çfarë zgjidhje do të bëjnë për këtë problem .

Kryetari : Tereni i futbollit që ka ekzistuar është privatizuar, janë identifikuar disa zona ku mundet të kemi teren të futbollit , mirëpo duhet ti shikojmë mundësitë se si mundemi ta kompozojmë AKP-në , unë i kamë kërkuar që të rifreskohen të gjitha pronat komunale dhe sot mi kanë dërguar në zyrën time andaj ne do të gjejmë një zgjedhjeje për këtë teren sportiv sepse është e nevojshme . Ne një ditë më parë jemi dakorduar me Ministrinë dhe me Federatën e futbollit të Kosovës që të ndërtohet një fushë e futbollit në Gjakovë të cilën e financon FIFA , e cila është teren për Stërvitje e jo Stadion , në të njëjtën kohë jemi dakorduar që ti ndajmë mjetet edhe për projektin e Stadionit . Për çështjen e banimit Social e di që nuk do me thënë të shkelet ligji për me bërë një gabim dhe arsyeja është se kemi më shumë kërkesa se sa që kemi banesa për banim social , andaj ne do të veprojmë në mënyrë që mos të kemi komisione permanente të banimit social por të gjejmë një zgjidhje të qëndrueshme .

z. Mimoza Shala: Unë dua ta ngrisë shqetësimin tim lidhur me mos ndriçimin e rrugëve kryesore ndër më të frekuentuarat e sidomos në këtë sitin të dimrit , andaj kërkoj nga drejtori për shërbime Publike që sa më parë të bëhet ndriçimi i këtyre rrugëve .

Kryetari: Në Buxhetin e Komunës për vitin 2018 janë parapara për ndriçim Publik 120.000€ buxhet i miratuar nga Kuvendi i kaluar, dhe borxhin që e ka komuna është fiks 120.000€ , që do më thënë se Komuna e Gjakovës nuk ka mjete për këtë vit për ndriçim publik, por ne jemi duke u munduar dhe do të gjejmë zgjedhje ose me lëvizjen e mjeteve me sigurimin e mjeteve nga Qeveria Qendrore .

Kryesuesi: Nëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur këtë mbledhje dhe mirë u takofshin në takimin e radhës .

Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 12:20 .

Procesmbajtës

Burim Bajrami

Kryesuesi i Kuvendit

z. Anton Shala